



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 3 nëntor 2014
Nr. ref.:RK717/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI106/14

Parashtrues

Kompania „Adler Com sh. p. k.“

**Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 47/2013, të 17 majit 2014**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar
Arta Rama - Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga kompania „Adler Com sh. p. k.“, fshati Gërçinë, Komuna e Gjakovës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilën e përfaqëson avokati z. Bajram Morina nga Gjakova.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. nr. 47/2013, e 17 majit 2014.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [E. Rev. nr. 47/2013] të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 17 majit 2014, me të cilin, sipas pretendimit të parashtruesit, është shkelur neni 3 [Barazia para Ligjit], neni 7 [Vlerat], neni 21 [Parimet e Përgjithshme], neni 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 20 qershor 2014, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 7 korrik 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI106/14, caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. KSH. KI106/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 14 gusht 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 15 shtator 2014, Kryetari i Gjykatës me Vendimin nr. KSH. KI106/14, zëvendësoi gjyqtarin Robert Carolan me gjyqtarin Almiro Rodrigues.
9. Më 18 shtator 2014, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës parashtrroi padi në Gjykatën Ekonomike të Qarkut në Prishtinë kundër Komunës së Gjakovës, me të cilën ka kërkuar që pala e paditur në emër të fitimit të humbur për shkak të përjashtimit nga pjesëmarrja në tenderët komunalë, t'ia paguaj shumën në lartësi prej 1.319.057,67 €.

11. Më 15 tetor 2009, Gjykata Ekonomike e Qarkut nxori Aktgjykimin [IV. C. nr. 229/2009], me të cilin është refuzuar kërkesëpadia e parashtruesit si e pabazuar, me arsyetim:

„[...] gjykata konsideron se paditësit nuk i takon fitimi i humbur nga kjo bazë. Kjo për arsye se shpallja e tenderit nuk paraqet ftesë për lidhje të kontratës po është ftesë për garë tenderuese. Edhe me supozim se paditësi nuk është eliminuar nga gara tenderuese, nuk është e sigurt që kishte me fituar kushtin për lidhjen e kontratës në bazë të tenderit të shpallur. Pra baza e kërkesës së paditësit është e kushtëzuar nga plotësimi i një kushti të pa sigurt dhe gjykata në këto rrethana nuk mund të bazoi aktgjykimin e saj...”

12. Më 28 dhjetor 2009, përfaqësuesi i paditësit ka paraqitur me kohë ankesë ndaj aktgjykimit për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

13. Më 24 korrik 2013, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin [Ae. nr. 20/2012], me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar, me arsyetim:

“[...] se vlerësimi juridik i gjykatës së shkallës së parë i cili është cekur në Aktgjykimin [IV. C. nr. 229/2009], të 15 tetorit 2009, është i rregullt dhe i bazuar në dispozitat ligjore, dhe që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.1 të LPK, dhe rrjedhimisht Gjykata e Apelit e miraton këtë vlerësim në tërësi”. Në përfundimin e Aktgjykimit, Gjykata e Apelit thekson: “[...] se në bazë të nenit 189 paragrafi 1 të LMD është përcaktuar se i dëmtuari ka të drejtë si në kompensimin e dëmit të thjeshtë ashtu edhe për kompensimin e fitimit të humbur, ndërsa me paragrafin 3 të nenit në fjalë është përcaktuar se me rastin e vlerësimit të fitimit të humbur, merret parasysh fitimi i cili vërtetë ka mundur të pritej sipas rrjedhjes së rregullt të çështjes ose sipas rrethanave të veçanta, realizimi i të cilave është penguar nga veprimi ose lëshimi i shkaktuesit të dëmit, d.m.th. përcaktohet në para në bazë të vlerës të fitimit të cilin personi i dëmtuar vërtetë do ta realizonte nisur nga mënyra e vet e zakonshme e jetesës dhe punës, sikur të mos ekzistonte veprimi dëmtues i shkaktarit të dëmit ose lëshimit të tij, dhe caktohet në bazë të çmimeve në kohën e marrjes së vendimit gjyqësor. Paditësi gjatë gjithë procedurës nuk i ka provuar këto fakte sipas të cilave kishte bazë ligjore për të kërkuar fitimin e humbur”.

14. Më 2 tetor 2013, kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [Ae. nr. 20/2012] të 24 korrikut 2013, përfaqësuesi i paditësit ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme të anulojë aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët dhe lënda të kthehet për rivendosje.

15. Më 13 mars 2014, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin [E. Rev. nr. 47/2013], me të cilin hodhi poshtë kërkesën e parashtruesit si të pabazuar, me arsyetim se:

"[...] janë të pabazuara thëniet e parashtruesit se gjykatat e instancës më të ulët gabimisht kanë zbatuar të drejtën materiale dhe atë dispozitat e nenit 189 par. 1 dhe 3, nenit 154 par. 1, nenit 158 dhe nenit 185 par. 1 dhe 4 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit për shpërblimin e fitimit të humbur është e pabazuar, ngase gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë nuk kanë marrë për bazë faktin se paditësi është eliminuar nga tenderi për vitin 2008 për shkak të inicimit të procedurës për kundërvajtje ndaj paditëses...".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

16. Parashtruesi ka theksuar në kërkesë se Aktgjykimi i kontestuar [E. Rev. nr. 47/2013], i Gjykatës Supreme i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, dhe atë: neni 3 [Barazia para Ligjit], neni 7 [Vlerat], neni 21 [Parimet e Përgjithshme], neni 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave].

17. Parashtruesi i drejtohet Gjykatës me kërkesë:

"Anulimi - Prishja e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, E. Rev. Nr. 47/2013, Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ae. Nr. 20/2012 dhe të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë IV/C. Nr. 229/2009 në funksion të aprovimit të Padisë - Kërkesëpadi së parashtruesit të kësaj kërkesë për kompenzimin e dëmit në shumë të përgjithshme prej 1,319,057.67 Euro".

Pranueshmëria e kërkesës

18. Për të qenë në gjendje të gjykojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata para së gjithash duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i ka plotësuar kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës së Gjykatës.

19. Në këtë drejtim, neni 113 paragrafi 7 i Kushtetutës përcakton:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

20. Në këtë rast, Gjykata i referohet rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, i cili parashikon:

(1) "Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

[...]

c) kërkesa nuk është qartazi e pabazuar".

21. Siç është theksuar edhe më lart, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi [E. Rev. nr. 47/2013] i Gjykatës Supreme të Kosovës i 17 majit 2014,

i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 7 [Vlerat], nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

22. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesi në kërkesë nuk ka shpjeguar se si dhe pse Aktgjykimi [E. Rev. nr. 47/2013] i Gjykatës Supreme i ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, por ka tentuar që thëniet e tij për shkeljet e cekura t'i justifikoj me pretendimin se: „[...] i janë cenuar rendë të drejtat Kushtetuese dhe shkaktuar dëme i konsiderueshëm materiale dhe morale...”.
23. Gjykata Kushtetuese ripërsëritë se sipas Kushtetutës nuk është detyrë e saj që të veprojë si Gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet e marra nga gjykatat e rregullta. Është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, GJEDNJ, aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin KI70/11, parashtruesi i kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).
24. Gjykata Kushtetuese mundet vetëm të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë zbatuar në mënyrë të tillë që parashtruesit e kërkesës kanë pasur gjykim të drejtë (shih, ndër autoritete tjera, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i miratuar më 10 korrik 1991).
25. Në bazë të shkresave të lëndës, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme është i qartë, dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata, gjithashtu, gjeti se procedurat në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Ekonomike të Qarkut nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituaniës*, nr. 17064/06, Vendimi i GJEDNJ-së, i 30 qershorit 2009).
26. Për më tepër, Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj ka gjetur „[...] se gjykata e shkallës së dytë ka zbatuar drejtë të drejtën materiale kur e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit dhe ka konfirmuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për çka ka ofruar arsye të mjaftueshme të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, si dhe ka vlerësuar si të pabazuara thëniet e paditësit në revizion, se aktgjykimi i goditur është marrë me shkelje thelbësore nga neni 182.1 dhe 182.2 (n) dhe në kundërshtim me nenin 204 të LPK, ngase i mungojnë arsyet valide për refuzimin e ankesës së paditësit dhe faktet vendimtare për vërtetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, se në arsyetim nuk janë dhënë arsye për pretendimet ankimore dhe se dispozitivi i aktgjykimit është në kundërtënie me arsyet të dhëna dhe shkresat të lëndës”.
27. Gjykata thekson se pakënaqësia e parashtruesit me rezultatin e rastit, nuk është e mjaftueshme për të ngritur një pretendim të argumentuar për shkelje të dispozitave të Kushtetutës (shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

28. Si përmbledhje, Gjykata gjen se kërkesa e parashtruesit nuk i plotëson kushtet e pranueshmërisë, ngase parashtruesi nuk ka dëshmuar se vendimi i kontestuar i shkel të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë.
29. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 Kushtetutës, me nenin 47 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 18 shtator 2014, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TUA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit, dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Altay Suroy



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani